



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 823 , datë 21.10.2020

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.914, DATË 29.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në nenin 47/1, "Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër", të vendimit nr.914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 7 e 8, me këtë përmbajtje:

- "7. Përfundimisht nga sa është përcaktuar në këtë nen, gjatë gjendjeve të epidemisë të deklaruara zyrtarisht sipas legjislacionit në fuqi, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj të varësisë mund të prokurojnë mallra ose shërbime që mbulohen nga një marrëveshje kuadër nga operatorë ekonomikë të tjerë që nuk janë pjesë e marrëveshjes kuadër, në rast se operatorët ekonomikë të marrëveshjes kuadër kanë deklaruar me shkrim që, për shkak të gjendjes së epidemisë, janë në pamundësi për të përmbushur plotësisht ose pjesërisht detyrimin për të furnizuar mallrat ose shërbimet sipas marrëveshjes kuadër.
8. Në çdo rast, autoriteti kontraktor, përpara fillimit të çdo procedure të prokurimit publik për mallra ose shërbime që mbulohen nga një marrëveshje kuadër që nuk janë pjesë e marrëveshjes kuadër, sipas pikës 7, të këtij neni, është i detyruar për të kërkuar fillimisht furnizimin e

mallrave ose të shërbimeve nga operatorët ekonomikë që kanë lidhur një marrëveshje kuadër.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU

NR.PROT. 5219/1
DATE 22.10-2020

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaçi', is written over a circular blue official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKË SHQIPËRISË' at the top and 'MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE' at the bottom.